

## KRONIKË SHKENCORE E AKTIVITETEVE TË DEGËS SË GJUHËSISË PËR VITIN 2022

Më 6 qershor 2022, në Prishtinë, nisi punimet edicioni i 13-të i konferencës “Java e Albanologjisë” e organizuar nga Instituti Albanologjik. Në këtë edicion morën pjesë 90 studiues të shkencave albanologjike.

Në seancën solemne fjalën e hapjes e mbajti drejtori i Institutit prof. dr. Hysen Matoshi, i cili krahas shpalosjes së programit dhe temave që do të trajtohen theksoi se kjo konferencë mbahet në vigjilje të tre përvjetorëve të rëndësishëm të shkencave albanologjike: 60-vjetori i botimit të numrit të parë të revistës “Gjurmime albanologjike”, 50-vjetori i standardizimit të gjuhës shqipe dhe 40-vjetori i revistës “Gjuha shqipe”. Pas tij, me fjalë përshëndetëse të pranishmëve iu drejtuan: në emër të Akademisë së Studimeve Albanologjike, prof. dr. Valter Memisha (zëvendësrektor), kurse në emër të Institutit të Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve në RMV, prof. dr. Skënder Hasani (drejtor).

Promovimin e 30 titujve të ri të Institutit Albanologjik për vitin 2021 e udhëhoqi sekretari shkencor i IAP-it, prof. dr. Lulëzim Lajçi.

Në ditën e parë të këtij aktiviteti shkencor, i vazhdoi punimet sesioni i Gjuhësisë. Në nderim të dyzetvjetorit të themelimit të revistës “Gjuha shqipe”, temë e këtij sesioni ishte *Revista “Gjuha shqipe” – tribuna e rëndësishme për shqipen standarde dhe kulturën gjuhësore*. Në këtë sesion morën pjesë 30 kumtues nga qendrat më të rëndësishme albanologjike, si: Instituti Albanologjik, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (ASA) në Tiranë, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Prizrenit, Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës, Universiteti “Cyril and Methodius” (“Kirili dhe Metodi”) në Shkup, Universiteti i Gjilanit, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup etj.

Në këtë Konferencë morën pjesë:

1. Xhevat Lloshi, *Mbrojtja dhe lëvrimi i shqipes në faqet e një reviste*
2. Emil Lafe, *Revistat simotra "Gjuha jonë" e "Gjuha shqipe" dhe misioni i tyre i përbashkët për shqipen standarde dhe kulturën gjuhësore.*
3. Valter Memisha, *Ndihmesa e studiuesve nga Shqipëria në faqet e revistës "Gjuha shqipe" për vitet 1982-2000.*
4. Orjeta Baja, *Studiuesi Tomor Osmani në faqet e revistës "Gjuha shqipe"*
5. Asllan Hamiti, *Drejtskrimi i antroponimeve sllave.*
6. Artur Lama, *Perceptime dhe vlerësime të gjuhëtares Shefikje Islamaj për disa çështje të kulturës së gjuhës.*
7. Imri Badallaj, *Paskajorja gege dhe shqipja standarde.*
8. Naim Berisha, *Revista "Gjuha shqipe" dhe shqipja standarde.*
9. Begzad Baliu, *Rreth botimit të studimeve onomastike në revistën "Gjuha shqipe".*
10. Abdurrahim Maxhuni, *Ndihmesa e Akad. Idriz Ajetit në revistën "Gjuha shqipe".*
11. Irda Dervishi Nesimi, *Çështje të terminologjisë në faqet e revistës "Gjuha shqipe".*
12. Shpresa Ismajli, *Problematika gjuhësore të trajtuara në revistën "Gjuha shqipe".*
13. Adelinë Selmani, *Kontributi i Shefikje Islamajt në revistën "Gjuha shqipe".*
14. Edlira Troplini Abdurahmani, *Edukimi gjuhësor dhe gjuha standarde shqipe në kontekstin shqiptar.*
15. Albulena Zulbeari, *Gabimet drejtshkrimore në ditarët elektronikë-cikli fillor në rrethinën e Tetovës.*
16. Bahtijar Kryeziu, *Ndihmesa e Ymer Elshanit në pasurimin e fjalorit të nxënësve tanë.*
17. Ismet Osmani, *Gjuha shqipe në tekstet mësimore në shkollat 9-vjeçare në RMV.*
18. Idriz Metani, *Vëzhgime mbi fjalët dhe shprehjet popullore të botuara në revistën "Gjuha shqipe" (1982 - 2022).*

19. Zamira Shkreli- Erzen Koperaj, *Lidhja e shqipes standarde me dialektet përmes artikuljeve të revistës "Gjuha shqipe"*.
20. Berton Sulejmani, *Trajtesa sintaksore në revistën "Gjuha shqipe"*.
21. Evalda Paci, *Çështje të kulturës së gjuhës në tekste të veprave të letërsisë së vjetër shqipe*.
22. Mustafa Ibrahim, *Roli i revistës "Gjuha shqipe" për pastërtinë e gjuhës shqipe*.
23. Shkelqim Millaku, *Ndihmesa e Mehmet Çelikut për revistën "Gjuha shqipe"*.
24. Sejdi Gashi, *Kultura e gjuhës në medie sipas Isa Bajçincës*.
25. Vjosa Osmani, *Koherenca në tekste të nxënësve*.
26. Manjola Zaçellari, *Ndihmesa për kulturën e gjuhës e prof. Shefkije Islamajt në faqet e revistës "Gjuha shqipe"*.
27. Afërdita Abdullahi, *Kontributi i Isa Bajçincës për revistën "Gjuha shqipe"*.
28. Faton Krasniqi, *Kontributi i profesor Emil Lafes për revistën "Gjuha shqipe"*.
29. Farketa Dibra – Zeqiri, *Zbatimi i shqipes standarde në shkollat fillore të ciklit të lartë në qytetin e Shkupit*.
30. Hana Dardhishta, *Gjuha standarde shqipe në tekstet shkollore në Maqedoninë e Veriut*.

Më 16 – 18 nëntor 2022, në Universitetin e Tetovës u organizua Konferenca e shtatë ndërkombëtare shkencore „Gjuha, letërsia dhe kultura - arritjet dhe perspektivat”. Kjo Konferencë u organizua në bashkëpunim me: Institutin Albanologjik - Prishtinë; Fakultetin e Filologjisë - Universitetin e Prishtinës; Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë - Universitetin „Fan Noli” (Korçë); Fakultetin e Shkencave Humane (Departamenti i Gjuhësisë) - Universitetin e Elbasanit; Fakultetin e Filologjisë - Universitetin „Fehmi Agani” (Gjakovë); Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (Shkup); Fakultetin e Filologjisë - Universitetin e Beogradit; Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" - Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" (Shkup); Fakultetin e Shkencave Shoqërore - Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe Institutin e Makedonian Language "Krste Misirkov". Në këtë ngjarje të madhe shkencore, nga dega e Gjuhësisë e Institutit Albanologjik, me kumtesa u paraqitën këta studiues: Prof.

asoc. dr. Naim Berisha, prof. ass. Abdurrahim Maxhuni, prof. ass. Vjosa Osmani, prof. ass. Sejdi Gashi, prof. ass. Afërdita Abdullahi Dërmaku, prof. ass. dr. Faton Krasniqi dhe prof. ass. Shpresa Ismajli.

Me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, më 23 nëntor 2022, në ambientet e Institutit Albanologjik - Prishtinë, u mbajt seanca e dytë e Konferencës shkencore *Një komb – një gjuhë*. Kjo Konferencë u organizua nga tri qendrat kryesore albanologjike shqiptare: Instituti Albanologjik - Prishtinë, Akademia e Studimeve Albanologjike - Tiranë, dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup. Në këtë veprimtari shkencore, përveç punonjësve shkencorë nga Instituti Albanologjik, morën pjesë studiues nga Akademia e Studimeve Albanologjike në Tiranë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjilanit etj.

Më 26 nëntor 2022 përfundoi konferenca mbarëkombëtare *Një komb – një gjuhë*, e organizuar në 50-vjetorin e mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit të Shqipes. Kjo veprimtari shkencore u organizua nga tri qendrat kryesore albanologjike shqiptare, Instituti Albanologjik – Prishtinë, Akademia e Studimeve Albanologjike – Tiranë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup.

Më 22 nëntor 2022 u mbajt seanca e parë, në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Në këtë seancë të kësaj Konference të përbashkët, kumtesat e tyre i paraqitën këta studiues të degës së Gjuhësisë të IAP-it: prof. ass. dr. Abdurrahim Maxhuni dhe prof. ass. dr. Sejdi Gashi.

Më 23 nëntor 2022 u mbajt seanca e dytë, në Institutin Albanologjik në Prishtinë, kurse

më 25-26 nëntor seanca e tretë, në Akademinë e Studimeve Albanologjike në Tiranë.

Në harmoni me marrëveshjen e nënshkruar në mes të tri institucioneve organizuese, në seancën e tretë të mbajtur në Tiranë, nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, me kumtesa u paraqitën:

Prof. dr. Fadil Grajçevci – shef i Degës së Letërsisë dhe Prof. asoc. dr. Naim Berisha – shef i Degës së Gjuhësisë.

Më datë 27. 10. 2022, punonjës shkencorë të Institutit Albanologjik të Prishtinës morën pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të Ballkanologjisë *Ballkani dhe globalizimi*, të organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut (Shkup).

Nga Dega e Gjuhësisë e IAP-it, me kumtesat u paraqitën: Prof. ass. dr. Shpresa Ismajli, Prof. ass. dr. Sejdi Gashi, Prof. ass. dr. Vjosa Osmani dhe Prof. ass. dr. Afërdita Abdullahi.

Krahas aktivitetit shkencor u zhvilluan takime me përfaqësues e studiues të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut (Shkup) dhe me studiues të tjerë pjesëmarrës në Konferencë.

**Në kuadër të *Panairit të Botimeve Albanologjike*,  
në Institutin Albanologjik, u promovua revista “Gjuha  
shqipe” 40-vjet ruajtje dhe kultivim i kulturës së gjuhës**

Në kuadër të *Panairit të Botimeve Albanologjike* (4 e 5 tetor 2022), që organizohet nga tri institucionet shkencore: Instituti Albanologjik - Prishtinë, Akademia e Studimeve Albanologjike - Tiranë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në MV - Shkup, u bë edhe prezantimi i tetë numrave të revistës “Gjuha shqipe” (1/2/3/2020, 1/2/3/2021, 1/2/2022), revistës së vetme të specializuar për kulturën e gjuhës në hapësirat shqiptare. Për revistën “Gjuha shqipe” ky vit përkon me 40-vjetorin e themelimit të saj. Për revistën “Gjuha shqipe” 40-vjet ruajtje dhe kultivim i kulturës së gjuhës referuan: Prof. asoc. dr. Abdurrahim Maxhuni Prof. ass. dr. Shpresa Ismajli.

Në kuadër të veprimtarive të përbashkëta shkencore ndërmjet Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA), Tiranë; Institutit Albanologjik të Prishtinës (IAP) dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh), Shkup, që rrjedhin nga marrëveshja e lidhur midis këtyre institucioneve në vitin 2021, në mjediset e Institutit Albanologjik të Prishtinës, në datat 4 e 5 tetor 2022, u hap Panairi i Parë i Librit Albanologjik. Kjo veprimtari do të jetë e përvitshme dhe me rotacion nga njëra qendër kërkimore shkencore në tjetrën. Veprimtarinë e hapi drejtori i IAP-it, prof. dr. Hysen Matoshi. Pastaj përshëndetën rektori i ASA-s, prof. dr. Luan Përzhita, si dhe drejtori i ITSHKSH, prof. dr. Skënder Hasani, të cilët e vlerësuan këtë panair edhe një mundësi më shumë që libri shkencor të shkojë pranë përdoruesit të saj dhe e nxitjes së bashkëpunimit midis tri institucioneve për projekte e botime të përbashkëta.

**Në kuadër të panairi të librit në Institutin Albanologjik, u promovua vepra “Fjalor frazeologjik i arealeve shqipe të Maqedonisë së Veriut” e autorit Qemal Murati**

Më 5 tetor 2022, në kuadër të Panairi të Librit, në Institutin Albanologjik, u promovua vepra “Fjalor frazeologjik i arealeve shqipe të Maqedonisë së Veriut” e autorit Qemal Murati. Për këtë vepër foli Dr. Zeqirija Ibrahim – këshilltar shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. Në fjalën e tij, ai theksoi se: vepra “Fjalor frazeologjik i arealeve shqipe të Maqedonisë së Veriut”, e autori Qemal Murati, është ndër veprat më të rëndësishme të fushës së frazeologjisë që është botuar kurdoherë nga cilido autor në Maqedoninë e Veriut. Të pranishmëve iu drejtua edhe autorit i veprës, Qemal Murati, i cili shprehu falënderime për botuesin, pra Institutin, si dhe për recensentët e veprës. Me këtë promovim u mbyll dita e dytë e panairit të librit akademik, që sivjet për herë të parë është organizuar në Prishtinë.

**Akademia e Studimeve Albanologjike e Tiranës promovoi botimet e saj në Institutin Albanologjik**

Gjatë dy ditëve të panairit (4 e 5 tetor 2022) “Botime albanologjike”, edicioni i parë, Akademia e Studimeve Albanologjike ekspozoi në Prishtinë prurjet e viteve të fundit në fushat e historisë, arkeologjisë, antropologjisë kulturore dhe studimit të artit, gjuhësisë e letërsisë. Në ditën e parë të këtij aktiviteti, prof. dr. Valter Memisha (zëvendësrektor i ASA-s), bëri një prezantim të hollësishëm të botimeve më përfaqësuese për secilën fushë albanologjike.

Në ditën e dytë, u promovua monografia “Dardanët” (ASA, 2022), e prof. dr. Luan Përzhitës. Për këtë monografi referuan prof. dr. Valter Memisha, prof. dr. Aurel Plasari dhe prof. dr. Arben Hajdari. Hajdari, specialist i arkeologjisë, pranë Universitetit të Prishtinës, studimin monografik “Dardanët”, e vlerësoi si një punë të gjatë kërkimore shkencore në biblioteka dhe terren, bazuar në burime shteruese historike dhe arkeologjike, si një libër me vlerë për profesionistët e fushës dhe për studentët e mësimdhënësit, të cilët, në këtë monografi “do të gjejnë të sintetizuar, me mjaft kujdes, të dhëna mbi ecejaket e kësaj hapësire gjeografike nga parahistoria deri në mesjetë”.

Programi ka vijuar me prezantimet e botimeve të Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup.

### **Botimet e veçanta në vitin 2022**

Gjatë vitit 2022, punonjësit e Degës së Gjuhësisë, kanë përgatitur për botim revistat dhe aktet e konferencave:

#### **REVISTA SHKENCORE**

1. Gjuha shqipe 1 – 2022
2. Gjuha shqipe 2 – 2022
3. Gjuha shqipe 3- 2022

#### **Publikime të veçanta:**

1. Faton Krasniqi, *Analizë leksikore e teksteve shkollore të lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi për klasat 6 – 9 në Kosovë*, Prishtinë, 2022.
2. Abdurrahim Maxhuni, *Bibliografia e revistës “Gjuha shqipe” 1981- 2022*, Prishtinë, 2022.

**Faton KRASNIQI**



## KRONIKË SHKENCORE E AKTIVITETEVE TË DEGËS SË LETËRSISË PËR VITIN 2022

Dega e Letërsisë, në vitin 2022, në vazhden e punës kërkimore-shkencore ka mbajtur konferencën shkencore “Java albanologjise” edicioni i trembëdhjetë (6-10 qershor), aktivitet shkencor i përvitshëm i Institutit Albanologjik.

Në këtë konferencë u prezantuan dhjetëra kumtesa nga studiues të shquar të letërsisë shqipe të cilët paraqitën kumtesat e tyre në dy seanca të ndara.

Seanca e parë e drejtuar nga Gëzim Aliu dhe Virion Graçi, u hap me fjalën hyrëse dhe përshëndetëse të drejtuesit të Degës së Letërsisë të Institutit Albanologjik prof. dr. Fadil Grajçevcit, për të vazhduar pastaj me referatin e prof. dr. Agim Vincës “Romani “Arka e djallit” i Dritëro Agollit – një vepër polifonike. Seanca vazhdoi me kumtesat e studiuesve, si në vijim: Sali Bytyçi: “Tregimi i realizmit socialist në Kosovë (1945-1968)”, Hysni Ndreu: “Botët në shmang të novelave të Camajt”, Hysen Matoshi: “Fillimet e prozës shqipe në Kosovë”, Blerina Rogova Gaxha: “Tat Tanushi: Eros e Theos”, Muharem Jakupi: “Disidencat letrare e Ismail Kadaresë sipas një “studiuesi” impresionist francez”, Rovena Mikeli Vata: “Ironia në romanin: “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, Gëzim Aliu: “Ismail Kadare dhe realizmi socialist” dhe Virion Graçi: “Proza e shkurtër e Ismail Kadaresë në botimet e vitit 1981: “Emblema e dikurshme”, tregime e novela; “Vepra letrare II”, tregime e novela”.

Seancën e dytë e drejtuan Arben Hoxha e Meliza Krasniqi. Kumtesat e tyre, në këtë seancë i paraqitën studiuesit: Fadil Grajçevci: “Proza e Adem Demaçit (1945-1990)”, Arben Hoxha: “Aftësitë e munguara krijuese në krijimtarinë letrare shqiptare”, Jolanda Lila: “Kalvari i botim-ndalimit të romaneve të Petro Markos”, Adil Olluri: “Romani i Jusuf Gërvallës”, Brikene Ceraja – Beka: “Dramaciteti i familjeve korçare

(Mbi tregimet e Thoma Kacorrit)”, Eriola Çoçaj: “Zhanri dhe narratori në veprën “Vdekja më vjen prej syve të tillë””, Meliza Krasniqi: “Romanet e Petro Markos (analizë narratologjike)” dhe Shkurtë Kadriu Çitaku: “Narracioni te tregimi “Ora” i Anton Pashkut”.

Pas leximit të kumtesave, studiuesit pjesëmarrës zhvilluan edhe diskutime lidhur me kontributet e prezantuara. Punimet e këtij sesioni u mbyllën me një përmbledhje të shkurtër të gjithë asaj që u tha në këtë sesion dhe falënderimin e pjesëmarrësve me kumtesa e diskutime nga drejtuesi i degës së Letërsisë, Fadil Grajçevci.

### **Tryezë shkencore**

Tryeza shkencore: “Ali Podrimja në 80 vjetorin e lindjes dhe 10 vjetorin e vdekjes” u organizua nga Dega e Letërsisë e IAP-it dhe u mbajt më 18. 10. 2022. Në këtë tryezë shkencore folën: prof. dr. Sali Bytyçi, prof. dr. Fadil Grajçevci dhe prof. dr. Arben Hoxha.

### **Veprimtaria botuese e Degës së Letërsisë gjatë vitit 2022:**

#### **REVISTA SHKENCORE**

1. Gjurmime albanologjike - seria e shkencave filologjike 52/2022

#### **Publikime të veçanta në vitin 2022**

**Sali Bytyçi**, *Letërsia e Tjetrit përballë realizmit socialist (1944-1991): I – Poezia* (studim monografik).

**Adil Olluri**, *Pikëpjekje letrare* (përmbledhje punimesh).

**Meliza KRASNIQI**

## **VII. IN MEMORIAM**

